



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 13
07.03.2017

NR. VENDIMI 10
10.03.2017

VENDIM

“Për rekokimin e sekuestrimit të pasurisë”

Gjykata e Shkallës së Parë
për Krime të Rënda Tiranë, e përbërë prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Valbona Demiraj**, sot në datën **10/03/2017, ne Tirane**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore **kërkesën**, që i përket :

Kërkues: **1-Shoqëria “xxxx xxxxxx xxxx xxxxxx” Sh.p.k. me admnistrator C. B. , përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë av. T. K. , anëtar i Dhomës së Avokatisë Durrës me nr. License profesionale XXXX.**
2-C. N. B. , përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë av. T. K. , anëtar i Dhomës së Avokatisë Durrës me nr. License profesionale XXXX.

Objekti: Revokimin e sekuestrës së vënë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda me anë të vendimit nr. 18 datë 20.09.2016 duke vendosur heqjen e sekuestrës së llogarive bankare në emër të z.C. B. dhe shoqërisë së tij “xxxx xxxxxxxx xxxx xxxxxx” pranë Veneto Bank; dhe heqjen e sekuestrimit të pasurive të paluajtshme dhe të

luajtshme dhe rikthimin e administrimit të tyre shoqërisë dhe z.C. B. .

Baza Ligjore: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, të zhvilluar në prani të :

-kërkueses **Shoqëria “xxxx xxxxxxxx xxxx xxxxxxxx” Sh.p.k** që nëpërmjet përfaqësuesit të saj av. T. K. kërkoi: **pranimin e kërkesës,**

-të prokurores Doloreza Musabelliu që kërkoi: pranimin e kërkesës,

kjo gjykatë pasi dëgjoi kërkimet e palëve ndërgjyqëse dhe shqyrtoi aktet e paraqitura:”

VEREN se :

Kërkuesit **Shoqëria “xxxx xxxxxx xxxx xxxxxxxx” Sh.p.k me administrator shtetasin C. B. dhe vetë ky i fundit personalisht,** nëpërmjet përfaqësuesvë të tyre kanë paraqitur para kësaj gjykate kërkesën për revokimin e sekuestros së vendosur me vendimin nr. 18, datë 20/09/2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë mbi pasuritë e tyre konkretisht shuma monetare në llogari bankare në zbatim të ligjit **nr.10192 date 03/12/2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë” për shkakun se Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur pushimin e hetimit pasuror ndaj tyre

Përfaqesuesja e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë pranoi si të drejtë dhe të bazuar kërkimin e tyre mbi argumentin se organi i akuzes e ka pushuar procedimin pasuror pasi ka hetuar dhe ka konkluduar se pasuaritë objekt i këtij gjykimi kanë prejardhje të ligjshme dhe nuk janë produkt i ndonje veprimtarie kriminale.

Kjo gjykatë e gjen të drejtë dhe të bazuar kërkimin e kërkuesve të cilin e pranon mbi këto argumenta:

Mbi kërkesën e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë e cila kishte rregjistruar procedimin pasuror nr. 03 te vitit 2016 në emer të C. B. dhe shoqërisë së tij “**XXXX XXXXXXXX XXXX XXXXXXXX**” **sh.p.k** , kjo gjykatë me vendimin nr. 18, datë 20/09/2016 ka vendosuar sekuestrimin e pasurive të mëposhtme :

- Vlerën monetare prej 756,24 USD, 117,97 Lek, 28,393.43 EURO, të ndodhura në bankën “Veneto Bank”, në llogarinë bankare me nr. XXX, si dhe të gjitha shtesat në këtë llogari në emër të shoqërisë “**XXXX XXXXXXXX XXXX XXXXXXXX**” **sh.p.k**, deri në momentin e sekuestrimit.
- Vlerën monetare prej 250,903.64 EURO të ndodhur në bankën “Veneto Bank”, në llogarinë bankare me nr. XXX, si dhe të gjitha shtesat në këtë llogari, në emër të shtetasit C. B. , deri në momentin e sekuestrimit.

Ky vendim i kësaj gjykate është ekzekutuar nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë dhe me administrimin e kësaj pasurie në këta fazë është ngarkuar si administratore **znj. Burbuqe Islami.**

Me vendimin e datës 03/03/2017 Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur pushimin e procedimit pasuror 3/2016, pasi ka konkluduar pas një hetimi të gjatë se këto pasuri kanë prejardhje të ligjshme.

Lidhur me masen e sekuestros se vendosur mbi këto pasuri në emër të të C. B. dhe shoqërisë së tij “**XXXX XXXXXXXXXX XXXXX XXXXXXXXXX**” **sh.p.k** në kushtet kur prokurori ka pushuar hetimin pasuror për të cilin ato ishin sekuestruar (ngjirë) pushojnë dhe efektet e sekuestrimit të tyre, në kuptim të nenit **12/5** te ligjit **nr.10192 datë 03/12/2009** “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”.

Për këtë arsye kjo gjykatë pranon kërkimin e palës kërkuese dhe vendos revokimin e masës së sekuestros së vendosur me vendimin e saj nr. 18, datë 20/09/2016 vetëm mbi këto pasuri për të cilat kjo gjykatë ka disponuar.

Për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me nenin 14 te ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009** urdhërohet Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Tiranë dhe vihet në dijeni administratori **zi.Burbuqe Islami**, e cila është caktuar për administrimin e kësaj pasurie, administratore pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me sipër në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe

Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”, kjo gjykatë pasi formoi bindjen dhe në mbështetje të provave të shqyrtuara në këtë gjykim

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Revokimin e masës së sekuestros së vendosur me vendimin nr. 18, datë 20/09/2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë mbi pasuritë:

- Vlerën monetare prej 756,24 USD, 117,97 Lek, 28,393.43 EURO, të ndodhura në bankën “Veneto Bank”, në llogarinë bankare me nr. XXXX, si dhe të gjitha shtesat në këtë llogari në emër të shoqërise “**xxxx xxxxxxxx xxxx xxxxxxxx**”sh.p.k , deri në momentin e sekuestrimit.
- Vlerën monetare prej 250,903.64 EURO të ndodhur në bankën “Veneto Bank”, në llogarinë bankare me nr. XXXX, si dhe të gjitha shtesat në këtë llogari, në emër të shtetasit C. B. , deri në momentin e sekuestrimit.

3. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbarrimit Tiranë.

4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore e kësaj gjykate të njoftojë për këtë vendim administratoren **znj. Burbuqe Islami**, e cila është caktuar për administrimin dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara, administratore pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda afatit ligjor.

U shpall sot në Tirane, me datë 10/03/2017.

SEKRETARE

Valbona DEMIRAJ

GJYQTARE

Iliriana OLLDASHI

